



**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së,
për semestrin e dytë të vitit akademik 2025 - 2026
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në University of Kassel, Gjermani.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe University of Kassel, publikohet thirrja për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Kassel.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master të Universitetit Politeknik të Tiranës, të jenë në vit të fundit të studimeve, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Llojet e mobilitetit për studentët përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për praktikë mësimore dhe punim diplome.

Kohëzgjatja e bursës: Semestri i II i vitit akademik 2025 - 2026

Numri total i studentëve: 2

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.

Përparësi në nominimin e studentëve kanë studentët që u përkasin grupeve të disavantazuara. Studentët që u përkasin këtyre grupeve të disavantazuara kanë përparësi edhe për trajtim financiar. (Studentë, prindërit e të cilëve kanë vdekur në krye të detyrës; studentë me ndihmë financiare; studentë me nevoja të veçanta; studentë prindërit e të cilëve kanë nevoja të veçanta, studentë që kanë marrë statusin e jetimit; studentë që kanë qenë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore; studentë të grupeve etnike; studentë, prindërit e të cilëve ishin të dënuar të regjimit komunist; studentë, prindërit e të cilëve janë në pension etj.)



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është: English-B2, ose Gjermanisht B1.*

Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Kassel lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Raktori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për t’u njohur me listën e lëndëve të ofruara nga University of Kassel, ju lutemi klikoni te:

Web: uni-kassel.de/go/radverkehr

[Cycling and Sustainable Mobility - FB14BAU - Uni Kassel](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 10 nëntor 2025, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:

rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al